



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 334/2 Prot

Gramsh më 02.02.2024

V E N D I M

Nr. 4 datë. 26. 01 .2024

P Ë R

**MIRATIMIN E MARËVESHJES SË NËNSHKRUAR NDËRMJET ISLAMIC RELIEF
WORLDWIDE- ZYRA NË SHQIPËRI (IRA) DHE BASHKISË GRAMSH ME OBJEKT
DHURIMIN E NJË AUTOAMBULANCE DHE TRANSFERIMIN E KËTIJ AKTIVI
AFAT GJATË NË FUNKSION TË SHËRBIMIT SPITALOR TË OFRUAR NGA
SPITALI GRAMSH**

Këshilli i Bashkisë Gramsh, në mbledhjet e tij të datës 26/01/2024, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit “Për miratimin e marëveshjes së nënshkruar ndërmjet Islamic Relief Worldwide- Zyra në Shqipëri (IRA) dhe Bashkisë Gramsh me objekt dhurimin e një autoambulkance dhe transferimin e këtij Aktivi Afat Gjatë në funksion të shërbimit spitalor të ofruar nga Spitali Gramsh. mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Per qeverisjen vendore” neni 8, neni 9 pika 1.1/a 1.1/b, neni 23, neni 54 piakat, e dhe k, Ligjin Nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar),Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” I ndryshuar neni 108 pika a

V E N D O S I

- 1- Të miratojë marëveshjen nr. 5142 prot. datë 29.12.2023 e nënshkruar ndërmjet Islamic Relief Worldwide- Zyra në Shqipëri (IRA) dhe Bashkisë Gramsh me objekt dhurimin e një autoambulance.
- 2- Të miratojë vlerën e bashkëfinancimit nga Bashkia Gramsh për këtë objekt në vlerën 10% ose 730,000 lekëfond i cili do të mbulohet nga zëri bashkëfinancime për investime parashikuar me VKB Nr 88 datë 27.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor të vitit 2024” Pasqyra Nr. 9 (pasqyra e investimeve).

- 3- Të ransferohet Aktivi Afat Gjatë Autoambulancë në llogari dhe në kontabilitet të Drejtoria e Shërbimit Spitalor Gramsh.
- 4- Të çregjistrohen nga inventari kontabël i Bashkisë Gramsh A.A.M që transferohen sipas pikës 3 të këtij vendimi.
- 5- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Financës dhe buxhetit dhe Drejtori i Shërbimit Spitalor Gramsh.
- 6- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Kryetari i Këshillit të Bashkisë

Enis ZANI

